



Datë: 11.08.2025

Numër Protokolli: 5367/2025

A.nr.1114/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare , Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1114/2025, të datës 11.06.2025, të parashtruar nga ankuesi N.O, kundër organit të punësimit: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës numër A.nr.1114/2025, të datës 11.06.2025, e parashtruar nga ankuesi N.O.

A r s y e t i m

Kandidatit për pranim në shërbimin civil, N.O (në tekstin e mëtejme referuar: *ankuesi*), me datë 11.06.2025, ka parashtruar ankesë, e regjistruar nën shenjë A.nr.1114/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Konkursit me numër reference RN00017154, të shpallur me datë 21.03.2025 nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, për Grupin e Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës, gjegjësisht për pesë (5) pozitat e punës “*Inspektor i Tokës Bujqësore*”, Klasa-Profesional 1.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ndërsa, kjo e fundit më datë 30.06.2025, ka përcjell përgjigje në ankesë së bashku me provat materiale referuar çështjes në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë më datë 21.03.2025 ka shpallur konkursin me numër reference RN00017154, për Grupin

e Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës, pozita “ Inspektor i Tokës Bujqësore” klasa e pozitës Profesional 1, numri i kërkuar 5, ku afati për aplikim ka qenë nga data 22.03.2025 deri më 20.04.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në konkursin përkatës të punësimit kanë aplikuar gjithsejtë 77 kandidatë, ndërsa prej tyre kriteret e konkursit i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në listë të ngushtë 37 kandidatë, ndërsa ankuesit sipas Njoftimit me numër protokolli 2743 të datës 05.05.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore, i është refuzuar aplikacioni i punësimit me arsyetimin për shkak të mos plotësimit të kriterëve të konkursit, gjegjësisht përvojës së punës.

Tutje, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, me datë 29.05.2025, ka publikuar Njoftimin me numër protokolli 3163, nga i cili njoftim rezulton se kandidati L.Mme gjithsejtë 98 pikë, kandidati N.N me gjithsejtë 98 pikë, kandidatja N.S, me gjithsejtë 96.8 pikë, kandidatja E.S me gjithsejtë 93.6 pikë si dhe kandidati A.G me gjithsejtë 92.2 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi janë shpallur kandidatë fitues për pozitën e punës Inspektor i Tokës Bujqësore.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se plotëson kriterin e përvojës së punës ndaj kërkon ri shpalljen e konkursit.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit të parashtruara si në ankesë, thekson faktin se objekti i kësaj ankese është i njëjtë me objektin e ankesës për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1045/2025, të datës 07.08.2025, ku si për pasojë është anuluar Konkursi me numër reference RN00017154, për pozitën “Inspektor i Tokës Bujqësore”, i shpallur nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

Andaj, duke qenë se me Vendimin A.nr.1045/2025, të datës 07.08.2025, është anuluar Konkursi me numër reference RN00017154, për pozitën “Inspektor i Tokës Bujqësore”, në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedurës administrative në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: “*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*”.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1114/2025, të datës 11.06.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1114/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit N.O;
- U.D Menaxheres së Personelit në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, dhe;
- Arkivit të KPMSHCK- së.